

15 Shkurt – Dita Ndërkombëtare e Kancerit gjatë Fëmijërisë

Kanceri gjatë fëmijërisë

Kanceri është një sëmundje malinje, që prek të gjitha moshat, dhe për fat të keq nuk kursen as fëmijët. Leuçemia është një formë kanceri, që kryesisht prek moshat mbi 55 vjeç, por është forma më e shpeshtë e kancerit në moshat pediatrike.

Leuçemia është tumor (kancer) i rruazave të gjakut. Elementët e gjakut, rruazat e bardha (leukocitet), rruazat e kuqe (eritrocitet) dhe pllakëzat e gjakut (trombocitet), prodhohen në palcën e kockave. Ato prodhohen duke kaluar nga qeliza të papjekura në ato të diferencuara mirë, duke formuar qeliza të ndryshme me funksione të veçanta.

Në leuçemi, qelizat e papjekura të gjakut zhvillojnë kancer. Këto qeliza nuk mund të zhvillojnë funksionin e qelizave të gjakut, pasi kanë aftësi të madhe për t'u riprodhuar në mënyrë patologjike duke zënë palcën kockore dhe duke penguar prodhimin e mëtejshëm të leukociteve, eritrociteve dhe trombociteve.

Leuçemia mund të jetë akute apo kronike, në varësi të stadeve të zhvillimit të saj. Forma akute është një formë që zhvillohet shpejt dhe përkeqësohet gjithashtu shpejt. Forma kronike është formë e cila zhvillohet dhe përkeqësohet më ngadalë. Trajtimi dhe ecuria e leuçemisë është në varësi të tipit të qelizës që është zhvilluar si dhe në varësi të formës akute apo kronike.

Tipet e ndryshme të leucemive janë në varësi të cilës qelizë të gjakut është zhvilluar. Për shembull, leuçemia limfoblastike është kancer i limfoblasteve (rruazave të bardha-linfoblasteve- që luftojnë infeksionin).

Cilat janë shenjat dhe simptomat e leuçemisë?

Simptomat e leuçemisë variojnë në varësi të tipit të tumorit, por disa shenja të përgjithshme përfshijnë:

Temperaturë subfebrile, ethe

- Dobësi, lodhje e vazhdueshme
- Infeksione të shpeshta të përsëritura dhe shpesh herë të rënda
- Rënie në peshë e theksuar
- Zmadhim i gjëndrave limfatike, zmadhim i shpretkës dhe mëlçisë
- Shfaqje e të nxirave në trup dhe gjakoje me lehtësi
- Djerësitje e shtuar gjatë natës

- Dhimbje kockash.

Cilët janë faktorët që favorizojnë zhvillimin e leuçemisë?

Faktorët që rrisin rrezikun për të zhvilluar disa tipe të leuçemive janë:

- Anomalitë gjenetike. Disa anomali gjenetike si sindroma Down, janë të shoqëruara me një rrezik më të lartë për të zhvilluar leuçemi në moshat pediatrike.
- Ekspozimi ndaj disa lëndëve kimike, ekspozimi ndaj lëndëve si benzene–i cili gjendet tek benzina dhe përdoret në industrinë kimike- rrit rrezikun për shfaqjen e leuçemisë.
- Duhanpirja. Duhanpirja rrit rrezikun për të zhvilluar Leuçemi Mieloide Akute.
- Histori familjare për leuçemi. Nëse një pjesëtar i familjes është diagnostikuar dhe trajtuar me Leuçemi, atehërë persona me lidhje të afërt gjaku janë më të rrezikuar për të zhvilluar leuçemi.
- Trajtimi ndaj një kanceri të mëparshëm: Persona që kanë marrë kimioterapi apo radioterapi për të trajtuar një kancer, janë më të rrezikuar që të zhvillojnë me kalimin e kohës, tipe të ndryshme të leuçemisë.